



Image: ©Shutterstock

POLICY BRIEF

**Lufta kundër dezinformatave
në Maqedoninë e Veriut:
si mund t'i përgjigjet Kuvendi
kësaj sfide?**

Lufta kundër dezinformatave në Maqedoninë e Veriut: si mund t'i përgjigjet Kuvendi kësaj sfide?

Marko Pankovski dhe Vlora Reçica

Fushatat me dezinformata gjithnjë e më tepër po kërcënojnë demokracinë në nivel botëror. Pandemia e Kovid-19 ka rritur kërcënimin edhe më shumë, pasi dezinformatat dhe manipulimi me opinionin publik hyjnë në fushën e shëndetit publik. Në Maqedoninë e Veriut, përpjekjet për të adresuar dezinformatat janë të kufizuara në disa iniciativa me politika të udhëhequra nga Qeveria, si dhe iniciativa joformale nga OJQ-të lokale dhe ndërkombëtare, ndërsa Kuvendi dhe komuniteti më i gjerë janë të përfshira shumë pak.

Kuvendi në Maqedoninë e Veriut për momentin ka një rol jashtëzakonisht të kufizuar në luftën kundër dezinformatave ndërsa kjo temë asnjëherë nuk është debatuar në Kuvend. Kuvendi është përgjegjës të kërkojë llogaridhënie nga institucionet përkatëse me atë që ushtron autorizimet e tij legislative, përdor potencialin për bashkëpunim ndërkombëtar dhe rrit ndërgjegjësimin për pasojat negative nga dezinformimi, duke e ngritur kështu çështjen në nivel kombëtar. Është thelbësore që Kuvendi të marrë një qëndrim proaktiv për të kufizuar përhapjen e dezinformatave.

Edhe pse Kuvendi, organi më i lartë përfaqësues dhe legjislativi në vend, ka më pak mundësi

Pikat kryesore:

- Dezinformatat paraqesin sfidë serioze për Maqedoninë e Veriut, të cilat depërtojnë në të gjitha poret e politikës dhe shoqërisë, madje edhe në shëndetin publik.
- Kuvendi pothuajse nuk është i përfshirë në përpjekjet e vendit për të luftuar dezinformatat, pasi proceset e tilla kryesisht adresohen përmes strategjive dhe planeve të veprimit të qeverisë, si dhe përmes mediave dhe shoqërisë civile.
- Kuvendi duhet të krijojë grup parlamentar ndërpartiak për dezinformata, i cili do të jetë përgjegjës për hartëzimin e institucioneve dhe legjislacionit në lidhje me ballafaqimin me dezinformatat, ndërsa do të ofrojë edhe mbështetje për komisionet përkatëse parlamentare.

të ndikojë te autorët e përmbajtjeve me dezinformata, megjithatë mund të reagojë ndaj faktorëve që mundësojnë dezinformatat, si dhe ndaj aktorëve që i përhapin ato. Duke pasur parasysh se fushatat me dezinformata nuk paraqiten në vakum, ky punim analizon mënyrën strukturore dhe institucionale në të cilën vendi reagon ndaj dezinformatave, me fokus mbi rolin e Kuvendit. Punimi fokusohet mbi rolin e Kuvendit në zhvillimin dhe mbikëqyrjen e politikave dhe mekanizmave për luftën me dezinformatat, cili në Kuvend është përgjegjës për procedim në lidhje me kërcënimet nga dezinformatat, si dhe deri në çfarë niveli Kuvendi është i përfshirë në luftimin e dezinformatave. Përveç Kuvendit, me këtë punim shkurtimisht shqyrtohet edhe ndikimi i proceseve të jashtme në këtë kontekst, si anëtarësimi i vendit në NATO dhe ambiciet e tij për anëtarësim në BE.

Së pari, teksti ofron një pasqyrë të shkurtër të kontekstit të dezinformatave në Maqedoninë e Veriut. Më pas ofrohet këqyrje mbi rolet e Kuvendit, Qeverisë dhe mediave në luftën kundër dezinformatave. Së fundi, ofrohen mënyra me të cilat do të avancohet roli dhe kontributi i Kuvendit në luftën kundër dezinformatave. Hulumtimi bazohet në mbledhjen dhe analizën e të dhënave dytësore përmes një rishikimi të literaturës, legjisllacionit dhe normave dhe praktikave ndërkombëtare, si dhe të dhëna parësore si intervista me aktorë përkatës nga mediat, qeveria dhe institucionet tjera shtetërore. Në mënyrë që të bëhet vlerësim empirik i rëndësisë së pyetjeve të paraqitura në hulumtim, kemi përdorur të dhëna kërkimore dytësore dhe parësore.

Dezinformatat në Maqedoninë e Veriut

Në vitin 2016, Maqedonia e Veriut u shfaq në lajmet botërore si burim i lajmeve të rreme që ndikuan mbi votuesit amerikanë në zgjedhjet presidenciale të 2016-ës në SHBA. Shumë nga postimet virale me dezinformata në lidhje me zgjedhjet amerikane buronin nga Velesi, i cili tërhoqi vëmendjen vetëm pas fitores së ish-presidentit të SHBA-ve, Donald Trump. Ndërsa u rritën shqetësimet për efektet negative nga dezinformatat, platformat sociale si Facebook dhe Twitter hoqën qindra llogari të rreme në mediat sociale të përdorura nga operatorë nga Maqedonia e Veriut ndërsa Google pezulloi reklamat nga faqet e tilla të internetit. Mirëpo, në vitin 2020, tashmë janë gjetur mënyra të reja dhe platforma alternative për përhapjen e dezinformatave, siç është “Parler”, një platformë amerikane për rrjetëzim social.¹

Edhe vendi ynë është bërë viktimë e lajmeve të rreme dhe dezinformatave. Shembull për këtë është referendumi për ndryshimin e emrit të vendit në vitin 2018, i cili u zhvillua në kuadër të Marrëveshjes së Prespës me Greqinë, i cili synonte zgjidhjen e kontestit tre dekadash për emrin e vendit. Para referendumit, disa burime të Qeverisë, gazetarë dhe analistë të pavarur raportuan një sërë përpjekje për dezinformata në internet, me qëllim të bindin publikun që të bojkotonte referendumin. Shtrirja e një fushate të tillë me dezinformata, e cila përfshinte aktorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, ishte një tregues se sa i cënueshëm

¹ P. Sinovic dhe M. Mitevska, «Lajmet e rreme», Faqet në Maqedoninë e Veriut e prezantojnë veten si konservatorë amerikanë në vigjilje të zgjedhjeve në SHBA, 2020, në dispozicion në <https://www.rferl.org/a/macedonia-fake-news-sites-us-election-conservatives/30906884.html>

është vendi ndaj dezinformatave. Kjo cënueshmëri u bë edhe më e theksuar gjatë pandemisë së Covid-19, pasi dezinformatat ndikojnë mbi perceptimin e publikut se si vendi po përballëj me krizën shëndetësore dhe u përhapën dezinformata për pasojat negative nga vaksinimi. Mosmarrëveshjet politike të brendshme dhe të jashtme, e bëjnë vendin edhe më të cënueshëm ndaj dezinformatave. Sipas disa studimeve, shumica e fushatave dezinformuese synojnë të provokojnë konflikt ndëretnik, të dëmtojnë marrëdhëniet ndërkombëtare në Maqedoninë e Veriut dhe të pengojnë proceset politike, siç janë zgjedhjet.²

Lufta kundër dezinformatave ishte një nga prioritetet e Qeverisë aktuale, e udhëhequr nga Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë (LSDM), e cila erdhi në pushtet në vitin 2017. Në vitin 2019, kryeministri i atëhershëm Zoran Zaev, paralajmëroi Planin për aksion vendimtar kundër përhapjes së dezinformatave, i cili përveç tjerash përfshin disa aktivitete jodetyruese që kanë për qëllim luftimin e dezinformatave. Plani është i ndarë në dy pjesë. E para parashikon masa sigurie, kurse e dyta masa proaktive. Plani nënvizon angazhimin strategjik dhe bashkëpunimin aktiv të Qeverisë me BE-në dhe NATO-n. Për sa i përket sigurisë, plani ofron një sërë protokolle të sigurisë së brendshme për Qeverinë dhe organet qeveritare për të parandaluar sulmet e jashtme në infrastrukturën e TI-së dhe për të përmirësuar koordinimin e brendshëm.

Masat proaktive në plan synojnë rritjen e transparencës në mënyrë që publiku të ketë besim më të madh tek institucionet. Plani parashikon krijimin e një grupi operacional për luftë kundër dezinformatave dhe sulmeve ndaj demokracisë përmes fushatave edukative dhe bashkëpunimit me mediat sociale, si dhe një strategji kombëtare për edukimin mediatik që përfshin institucionet, median dhe shoqërinë civile. Masat parashikojnë gjithashtu diskutime ndërmjet mediave (shoqatave të tyre) dhe sektorit të shoqërisë civile për të arritur vetë-rregullimin dhe bashkë-rregullimin dhe vendosjen e standardeve për internet portalet, në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian dhe Këshillit të Evropës.⁴

Megjithëse masat e mësipërme janë gjithëpërfshirëse, mungon zbatimi. Deri më tani, zbatimi është kufizuar në aktivitetet e transparencës dhe edukimit mediatik.⁵ Dezinformatat ende janë problem i madh për Maqedoninë e Veriut, ndërsa me fushatat dezinformuese rrezikohen proceset demokratike. Me rritjen e intensitetit dhe shtrirjes së fushatave të dezinformimit për shkak të pandemisë së covid-19, është e nevojshme të bëhet përshtatja e Planit për Veprim të vendosur kundër përhapjes së dezinformatave, për t'ju bërë ballë sfidave të reja. Qeveria duhet të fillojë konsultime të hapura me palë të interesuara përkatëse, duke përfshirë organizatat e mediave dhe shoqërinë civile, në mënyrë që të zhvillojë një plan më aktual dhe më përkatës. Në veçanti, Kuvendi duhet të marrë një rol aktiv në revizionin e planit përmes konsultimeve dhe diskutimeve publike. Përveç kësaj, Kuvendi duhet të forcojë mbikëqyrjen mbi planin aktual, duke përfshirë (mungesën) e zbatimit.

² C. Green (et al.) «Hartëzimi i lajmeve të rreme dhe dezinformatave në Ballkanin Perëndimor dhe identifikimi i mënyrave për zhdukjen e tyre në mënyrë efektive», 2020, në dispozicion në <[https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/653621/EXPO_STU\(2020\)653621_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/653621/EXPO_STU(2020)653621_EN.pdf)>

«Plani vendimtar i veprimit kundër përhapjes së dezinformatave», Qeveria e Maqedonisë së Veriut, në dispozicion në: <<https://vlada.mk/node/18641?ln=en-gb>>

⁴ Ibid.

⁵ Intervistë me zrtar qeveritar, Shkup, tetor 2021

(De) rregullimi ose vetë-rregullimi

Dezinformatat shfaqen dhe përhapen në mjedise konkrete rregullatore dhe institucionale. Për të adresuar këtë fenomen, është e nevojshme të zbulohen kushtet në të cilat dezinformatat zhvillohet më lehtë. Aktualisht në vend nuk ka ligje të dedikuara posaçërisht për luftë kundër dezinformatave. Problemi zgjidhet kryesisht përmes masave të tërthorta, masave të buta si planet e veprimit të Qeverisë, reforma në mediat dhe avancim i edukimit mediatik. Kuvendi pothuajse nuk është i përfshirë në proces ndërsa përpjekjet për ballafaqim me dezinformatat mbeten në duart e Qeverisë, shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare. Që nga konstituimi i Kuvendit pas zgjedhjeve parlamentare në korrik 2020, debatet publike kanë qenë të rralla ndërsa në asnjë prej tyre nuk është diskutuar për problemin me dezinformatat.

Në ndërkohë, online mediat, fituan një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në mbijetesën e demokracive. Grupe të ndryshme shoqërore, përdorin gjerësisht rrjetet sociale dhe internet portalet, ndërsa përmes tyre mund të përhapen informacione ose dezinformata për kohë të shkurtër dhe në gamë të gjerë. Kështu në mënyrë drastike rritet kërcënimi nga dezinformatat. Për shkak të faktit se rrjetet sociale dhe internet portalet janë në plan të parë të komunikimit online, dhe për shkak se dezinformatat janë në rritje, (de)rregullimi apo vetë-rregullimi është bërë një dilemë e zakonshme në demokracitë e vjetra por edhe në demokracitë e reja, si kjo e jona.

Megjithëse Kuvendi duhet të përfshihet në mënyrë aktive në luftën kundër dezinformatave, është e rëndësishme të ruhet liria e medias (tradicionale dhe sociale) dhe të mos i nënshtrohet tundimit për “zgjidhje të lehta” të cilat mund të nënkuptojnë kufizim të lirive. Censura duhet shmangur. Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), Instituti Maqedonas për Media (MIM) dhe Këshilli për Etikën në Mediat në Maqedoni (KEMM) kanë deklaruar publikisht në intervistat me ne se preferojnë vetë-rregullimin në vend të rregullimit, pasi rregullimi mund të rrezikojë lirinë e medias, lirinë e fjalës dhe rrjedhën e informacioneve. Përfaqësuesit e këtyre organizatave theksuan se legjislacioni aktual për mediat offline mund të zbatohet lehtësisht në sferën online. Redaktimi i tepërt i mediave, rezulton në autocensurë dhe është një kërcënim për lirinë e fjalës dhe informacionit. Prandaj, kundërshtimi i dezinformatave, devijimeve dhe abuzimeve duhet të bëhet përmes përdorimit të legjislacionit ekzistues, sigurim të tregut të pavarur mediatik financiar dhe angazhim për përmirësimin e edukimit mediatik digjital (që është gjithashtu pjesë e planit të qeverisë për luftë kundër dezinformatave). Për kundërshtimin më mirë dezinformatave dhe për forcimin e besueshmërisë së mediave, SHGM dhe KEMM kanë krijuar një faqe interneti për luftë kundër dezinformatave dhe forcimin e besueshmërisë së mediave, ku janë shënuar mediat që janë në pajtim me standardet e informimit të mirë.⁷

Përderisa Qeveria e Maqedonisë së Veriut shprehu mbështetjen e saj për përpjekjet për vetë-rregullim, Kuvendi nuk u përfshi në aktivitetet, nuk i komentoj publikisht përpjekjet, as nuk e ngriti këtë çështje në trupat punues apo në seancat plenare. Për më tepër, deputetët nuk arritën të promovojnë në mënyrë aktive mjetet për kundërshtimin e dezinformatave në vetë Kuvend apo në platformat e tyre të komunikimit. Prandaj, në shqyrtimin e legjislacionit

⁶ Intervista me përfaqësues të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) dhe Institutit Maqedonas për Media (MIM), Shkup, tetor 2021.

⁷ shiko www.promedia.mk

të ardhshëm, Kuvendi duhet të organizojë debate publike ku do të përfshihen pikëpamjet e mediave, veçanërisht kur bëhet fjalë për aspektet e vetë-rregullimit. Deklarata e fundit për Promovimin e Dialogut ndërmjet Parlamenteve dhe Shoqatave të Gazetarëve në Ballkanin Perëndimor, nënshkruar më 26 nëntor 2021, në Konferencën rajonale për promovimin e dialogut ndërmjet parlamenteve dhe gazetarëve nga Ballkani Perëndimor, e organizuar nga SHGM në bashkëpunim me Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, është një hap në drejtimin e duhur, pasi thekson rëndësinë e mbështetjes së Kuvendit për mediat e pavarura, që është parakusht për ballafaqim me dezinformatat.⁸

Qasje me të cilën përfshihet shoqëria në tërësi (whole-of-society approach)

Kuvendi ka për detyrë të shfrytëzojë kompetencat e tij dhe duhet të jetë më aktiv kur bëhet fjalë për ballafaqimin me dezinformatat. Deri më tani, këto aktivitete janë udhëhequr nga Qeveria, e cila është fokusuar në luftën kundër dezinformatave dhe kërcënimeve hibride, në përgjithësi. Në tetor 2021, Qeveria miratoi Strategjinë për Ndërtimin e Rezistencës dhe Ballafaqimin me Kërcënimet Hibride, pas së cilës vijoi Plani i Veprimit për vitin 2021-2025. Plani i Veprimit parasheh aktivitete mbikëqyrëse të Kuvendit dhe rekomandon që grupet joformale parlamentare të komunikojnë me shoqërinë civile. Ndonëse ky është një aspekt thelbësor i rolit të Kuvendit në ballafaqimin me dezinformatat, nisma të tilla duhet të udhëhiqen nga Kuvendi për të siguruar një sistem adekuat të kontrollit të ndërsjellë.

Me fenomenin e dezinformatave nuk mund të merret vetëm një subjekt ose çështja të zgjidhet vetëm me një propozim legjislativ. Kështu, Kuvendi duhet të përgatitet në mënyrë përkatëse, që të mund të ndërlidhë aspektet e ndryshme të dezinformatave me kompetencat konkrete në suazat e komisioneve parlamentare. Aktualisht, komisione të ndryshme punojnë në aspekte të ndryshme të dezinformimit pa pasur një kornizë konceptuale dhe referencë për luftën kundër dezinformatave. Këtu bëjnë pjesë Komisioni për Arsim, Shkencë dhe Sport, Komisioni për Mbrojtje dhe Siguri, Komisioni për Sistemin Politik dhe Marrëdhëniet Ndërmjet Bashkësive, Komisionin për Çështje Evropiane dhe Komisionin për Politikë të Jashtme. Ky konfigurim dhe shpërndarje e kompetencave nëpër komisione të shumta e vështirëson mendimin tematik në lidhje me luftën kundër dezinformatave, sepse asnjë komision nuk ka kompetenca të qarta dhe si pasojë kjo nuk i stimulon të veprojnë në lidhje me fenomenin si tërësi. Në këtë kontekst, Kuvendi duhet të konsiderojë krijimin e një grupi punues ndërpartiak për dezinformata, i cili do të ketë për detyrë të koordinojë angazhimet e komisioneve të ndryshme. Grupi i punës mund të vendosë themelet për një komision të pavarur për kundërshtimin e dezinformatave që do të luajë një rol udhëheqës në zhvillimin dhe mbikëqyrjen e legjislacionit të ri. Përveç koordinimit dhe zhvillimit, grupi i punës mund të mbledhë gjithashtu informacione hyrëse nga burime të jashtme (think tanks, agjenci të pavarura, etj.).

⁸ 'Deklarata për avancimin e dialogut ndërmjet parlamenteve dhe shoqatave të gazetarëve nga Ballkani Perëndimor, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, Shkup, 30 nëntor 2021, në dispozicion në: <<https://znm.org.mk/en/declaration-for-promotion-of-dialogue-between-parliaments-and-journalists-associations-in-the-western-balkans/>>

Potenciali i bashkëpunimit ndërkombëtar

Bashkëpunimi ndërkombëtar është një mjet i rëndësishëm që Kuvendit të pozicionohet në luftën kundër dezinformatave. Së pari, bashkëpunimi ndërkombëtar mund të kompensojë mungesën e kapacitetit në Kuvend për t'i informuar deputetët për zhvillimet më të fundit në politikat publike në drejtim të luftës kundër dezinformatave. Së dyti, bashkëpunimi ndërkombëtar mund të shërbejë si platformë për socializim që deputetët të mund të ndajnë dhe barazojnë njohuritë me homologët e tyre nga BE-ja, SHBA dhe NATO. Bashkëpunimi ndërkombëtar është thelbësor për informimin më të mirë dhe përmirësimin e punës së Kuvendit të Maqedonisë së Veriut.

Pjesa më e madhe e aktivitetit ndërkombëtar të Kuvendit, kanalizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në Unionin Ndërparlamentar, Asamblenë Parlamentare të NATO-s dhe Asamblenë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit në Evropën Juglindore (AP e PBEJL). Në maj 2019 Kuvendi i Maqedonisë së Veriut ishte mikpritës i takimit të Komisionit të Përgjithshëm të për Drejtësi, Çështje të Brendshme dhe Bashkëpunim të PBEJL. Sesioni përfundoi me Rezolutë për luftë kundër dezinformatave në Evropën Juglindore, e cila detyroi pjesëmarrësit e PBEJL-së, të “vazhdojnë përpjekjet e tyre kundër dezinformatave si një temë që duhet diskutuar vazhdimisht dhe që duhet mbajtur në nivele të ndryshme”. Pjesëmarrësit u inkurajuan gjithashtu të njohin ndikimin e dezinformatave, të zbatojnë masa proaktive dhe t'i kushtojnë vëmendje të veçantë “legjislacionit efektiv dhe të qartë që garanton transparencën e pronësisë së medias dhe të zhvillojnë udhëzime për mediat sociale, për të forcuar kapacitetet e komunikuesve publik dhe të angazhohen për edukimin mediatik.”⁹

Në Forumin Parlamentar për Internet Qeverisje në vitin 2019, deputetët u inkurajuan të bashkëpunojnë dhe të shkëmbejnë praktikën më të mira me kolegët parlamentarë, në lidhje me atë se si të ballafaqohen me politikën publike që kanë të bëjnë me internetin. U ra dakord që legjislacioni duhet të rishqyrtohet përsëri, me qëllim të bëhet ballë sfidave të epokës digjitale, gjatë çka u theksua se është e rëndësishme të përfshihen aktorët jo shtetërorë. Roli i parlamenteve është të krijojnë një kornizë ligjore për gjeneratat aktuale dhe të ardhshme të përdoruesve të internetit, në mënyrë që interneti të jetë i qasshëm, i hapur dhe i sigurt për të gjithë. Në këto procese me në qendër njerëzit, besimi i publikut duhet të jetë udhërrëfyes për parlamentet, edhe si ligjvënës por edhe në aktivitetin e tyre në internet.¹⁰ Rekomandime të tilla nuk nënkuptojnë rregullim më të rreptë të medias me çdo kusht, por një rol më domethënës të parlamenteve në botën e re digjitale.

Një mekanizëm tjetër për bashkëpunim ndërkombëtar është Asambleja Parlamentare e NATO-s (AP NATO). Gjatë sesionit të 67-të vjetor të AP të NATO-s, të mbajtur në tetor 2021, AP e NATO-s u angazhua për një qasje ndaj rezistencës që përfshin shoqërinë në tërësi dhe inkurajoi parlamentet të “mbrojnë vlerat dhe institucionet demokratike, si dhe procesin zgjedhor ta integrojnë në kushte bazë, veçanërisht kur përballen me sulme kibernetike dhe dezinformata”.¹¹

⁹ ‘Rezoluta për luftë kundër dezinformatave në Evropën Juglindore, PSJIE, Shkup, 10-11 maj 2019, në dispozicion në <http://rspcsee.org/assets/userfiles/GC%20JHS%202019/Resolution_Skopje_10-11_May_2019.pdf>

¹⁰ ‘Message from the Meeting of Parliamentarians participating in the 14th UN Internet Governance Forum’, Inter-Parliamentary Union, available at <https://www.intgovforum.org/multilingual/index.php?q=filedepot_download/7505/1807>

¹¹ Zhvillimi i një qasjeje të integruar dhe të koordinuar ndaj rezistencës së demokracive aleate që përfshin shoqërinë në tërësi», Asambleja Parlamentare e NATO-s, në dispozicion në <https://www.nato-pa.int/download-file?filename=/sites/default/files/2021-10/2021%20-%20NATO%20PA%20Resolution%20466%20-%20Resilience_0.pdf>

Paraprakisht, Komiteti për Demokraci dhe Siguri i AP-së, së NATO-s nxori një sërë rekomandime për aktivitete në nivel kombëtar, duke bërë thirrje për forcimin e kohezionit të brendshëm; krijimin e një qasjeje të përbashkët legjislative transatlantike për redaktimin e online përmbajtjeve për të parandaluar përhapjen e dezinformatave dhe propagandës; zhvillim të edukimit mediatik dhe digjital të qytetarëve; si dhe forcimin e “bashkëpunimit ndërdemokratik dhe ndërparlamentar në luftën kundër dezinformatave dhe propagandës.”¹²

Së fundi, Parlamenti Evropian (PE) ofron një bazë të mirë për Maqedoninë e Veriut që të mund të operacionalizojë përpjekjet e saj për të identifikuar kërcënimin nga dezinformatat në nivel kombëtar dhe evropian. Në qershor 2020, PE krijoi Komitetin e Posaçëm për Ndërhyrjen e Huaj në të gjitha Proceset Demokratike në Bashkimin Evropian, duke përfshirë dezinformatat. Komiteti që atëherë ka pasur disa diskutime mbi temën e dezinformatave, duke mbuluar një listë të gjerë të pasojave që kanë dezinformatat në jetën shoqërore dhe politike në Evropë.¹³ Ndërsa PE vazhdimisht angazhohet që BE-ja të trajtojë ndërhyrjen e huaj dhe dezinformatat në mënyrë më të vendosur, Kuvendi i Maqedonisë së Veriut po bën shumë pak për ballafaqim me dezinformatat si një nga çështjet thelbësore në procesin e demokratizimit. Angazhimet e PE-së, edhe pse të fokusuara në BE-në, mund të ofrojnë udhëzime të dobishme për vendet kandidate, si Maqedonia e Veriut.

¹² Forcimi i Rezistencës Demokratike të Aleancës kundër Dezinformatave dhe Propagandës», Asambleja Parlamentare e NATO-s, në dispozicion në <https://www.nato-pa.int/download-file?filename=/sites/default/files/2021-04/013%20CDS%2021%20E%20-%20DEMOCRATIC%20RESILIENCE%20AGAINST%20DISINFORMATION%20AND%20PROPAGANDA%20-%20SANCHEZ_0.pdf>

¹³ Debate në Parlamentin Evropian, c. <https://www.europarl.europa.eu/committees/en/inge/events/events-hearings>

Çfarë në të ardhmen

Shumë gjëra tregojnë se Kuvendi i Maqedonisë së Veriut duhet të merret më intensivisht me luftimin e dezinformatave. Për shkak se dezinformatat ndikojnë mbi shoqërinë, dhoma ligjvënese do të duhet t'i kundërvihet problemit përmes funksionit të tij bazë të krijimit të ligjeve, mbikëqyrjes mbi pushtetin ekzekutiv dhe përfaqësimit. Ky punim propozon pesë metoda me të cilat Kuvendi do të mund të merrej aktivisht me dezinformatat.

1. *Të miratojë vendime në mënyrë inkluzive.* Gjatë hartimit dhe shqyrtimit të ligjeve të reja që kanë të bëjnë me dezinformatat, Kuvendi duhet të konsultohet vazhdimisht me aktorët përkatës, gazetarë të shquar dhe shoqata të gazetarëve, me shoqërinë civile dhe ekspertët e arsimit. Kjo do të thotë diskutime të rregullta, seanca konsultative dhe debate publike. Vlerësimet e ndikimit të rregullativës, të cilat Kuvendi i Maqedonisë së Veriut nuk po i zbaton aktualisht, do të ishin një tjetër mekanizëm efektiv. Në këtë mënyrë, Kuvendi mund të vlerësojë në mënyrë efektive, efektet e mundshme të legjislacionit, duke siguruar njëkohësisht pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse të palëve të interesuara.
2. *Të kryejë mbikëqyrje.* Kuvendi duhet të kërkojë llogari nga Qeveria dhe ministritë përkatëse në lidhje me përpjekjet e tyre të ballafaqimit me dezinformatat dhe kërcënimet hibride. Kuvendi duhet të monitorojë dhe vlerësojë në mënyrë aktive zbatimin e Planit për veprim të vendosur kundër përhapjes së dezinformatave të vitit 2019, Strategjisë për ndërtimin e rrezistencës dhe përballje me kërcënimet hibride nga viti 2021 dhe Planin e Veprimit 2021-2025. Mbikëqyrja e këtyre proceseve duhet të jetë e përqendruar te performanca dhe të përfshijë një sërë aktorësh të cilët nuk do të vlerësojnë ndikimin e strategjive të tilla thjesht duke shënuar se cilat nga aktivitetet e parashikuara janë realizuar. Në këtë mënyrë, Kuvendi duhet të përdorë informatat hyrëse nga aktorë të jashtëm për dhomën ligjvënese, për t'u njohur më mirë me dezinformatat, për shembull informatat nga Agjencia e pavarur për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive ose mediat dhe shoqëria civile.
3. *Operacionalizimi i dezinformimit si koncept.* Kuvendi duhet të funksionalizojë konceptin e dezinformatave duke identifikuar komisionet parlamentare me kompetenca të drejtpërdrejta për të luftuar dezinformatat dhe legjislacionin përkatës dhe institucionet e pushtetit ekzekutiv. Kjo, ndër të tjera, mund të arrihet përmes formimit të grupit punues parlamentar ndërpartiak për dezinformata, i cili do të ketë përdetyrë të hartojë dhe mbështesë institucionet përkatëse, legjislacionin dhe komisionet përkatëse parlamentare, si dhe të shqyrtojë mundësinë e krijimit të një komisioni të posaçëm të fokusuar në dezinformatat. Gjithashtu, një parakusht thelbësor për të ushtruar mbikëqyrjen, është që Kuvendi të fuqizojë kapacitetet e administratës dhe shërbimeve parlamentare, mbi të gjitha të Institutit Parlamentar. Këto kapacitete janë me rëndësi thelbësore që deputetët të kenë informacion të përshtatshëm dhe të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në lidhje me dezinformatat.

4. *Të rrisë ndërgjegjësimin.* Kuvendi duhet të risë ndërgjegjësimin për pasojat e dëmshme nga dezinformatat përmes rritjes së angazhimit individual të deputetëve. Kjo do të thotë se deputetët duhet të shpjegojnë pasojat e dezinformatave në njësitë zgjedhore ku janë zgjedhur, për shembull përmes paraqitjes televizive në TV kanalin e Kuvendit. Në këtë drejtim, deputetët duhet të japin shembull të mirë duke kërkuar llogaridhënie reciproke kur në Kuvend do të ketë raste të përhapjes së dezinformatave.
5. *Bashkëpunimi ndërkombëtar.* Kuvendi duhet të përdorë mekanizmat e bashkëpunimit ndërkombëtar, mbi të gjitha Unionin Ndërparlamentar, Asamblenë Parlamentare të NATO-s dhe Asamblenë Parlamentare të Procesit për Bashkëpunim në Evropën Juglindore, si dhe bashkëpunimin me Parlamentin Evropian. Këto organe janë platforma të fuqishme përmes të cilave deputetët mund të njihen me qasjet më të fundit kur bëhet fjalë për dezinformatat që mund të zbatohen në kontekstin e brendshëm. Kuvendi duhet të ndërlidhet me këto mekanizma, të përmirësojë bashkëpunimin dhe të veprojë sipas rekomandimeve dhe angazhimit.

Këto rekomandime kanë për qëllim t'i mundësojnë Kuvendit të Maqedonisë së Veriut të ndërmarrë qëndrim të fortë në luftën kundër dezinformatave, t'u mundësojë deputetëve të udhëheqin përpjekjet kundër dezinformatave në vend dhe të jenë shembull për Maqedoninë e Veriut dhe më gjerë.

Biografite

Marko Pankovski është studiues i lartë në Institutin për Demokraci "Societas Civilis" – Shkup. Hulumtimi i tij përfshin qeverisjen e mirë, reformat në administratës publike, vlerësimin e ndikimit të rregullativës dhe ndikimin e huaj autoritar në Ballkanin Perëndimor.

Vlora Reçica është studiuese dhe udhëheqëse e Qendrës për Mbështetje Parlamentare dhe Demokratizim pranë Institutit për Demokraci "Societas Civilis" – Shkup. Në hulumtimin dhe përfaqësimin fokusohet në parlamentet dhe demokracinë parlamentare, ndërtimin e institucioneve, populizmin, politikat multietnike dhe proceset e demokratizimit.



CESS

The Centre for European Security Studies (CESS) is an independent institute for research and training, based in Groningen, the Netherlands. CESS seeks to advance security, development, democracy and human rights by helping governments and civil society face their respective challenges. CESS is an international, multidisciplinary and inclusive institute. Its work is part of the European quest for stability and prosperity, both within and outside Europe. CESS encourages informed debate, empowers individuals, fosters mutual understanding on matters of governance, and promotes democratic structures and processes.



DECOS

The DECOS project seeks to empower democratic institutions and civil society actors in their function of oversight of security. It does so by increasing capacities, enhancing cooperation, and fostering a culture of oversight of the security sectors of Albania, Kosovo, and North Macedonia.

In the DECOS project CESS works with:

- The Albanian Institute for Political Studies
- The Institute for Democracy and Mediation, Albania
- The Kosovar Institute for Policy Research and Development
- The Institute for Democracy 'Societas Civilis', North Macedonia



Ministry of Foreign Affairs of the
Netherlands

DECOS is funded by the Ministry of Foreign Affairs
of the Netherlands.